

Njoftim për përqendrim me të cilin ORVAS shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti, Kroaci do të fitojë kontroll mbi TURE shoqëri për hotelieri, turizëm, ndërtimtari dhe tregti d.o.o., Kroaci

(Lënda nr. 08-98/2025)

Në pajtim me nenin 15 të Ligjit për mbrojtje të konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më 09.06.2025, te Komisioni për Mbrojtje të Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit nga ana e ORVAS shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti, me seli në rr. Shën Leopold Mandiq 10, Dugopolje, Republika e Kroacisë, mbi TURE shoqëri për hotelieri, turizëm, ndërtimtari dhe tregti d.o.o., me seli në Porat 1, Postira (Komuna e Postirës), Republika e Kroacisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

ORVAS shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti, ka për veprimtari kryesore – aktivitetet e agjencive turistike dhe operatorëve turistikë. ORVAS është shoqëri që veçanërisht merret me aktivitetet e agjencive turistike dhe operatorëve turistikë (e specializuar për shërbime të dhënies me qira të jahtesh, anijeve me motor, katamaranëve, si dhe me qiradhënie të vilave turistike dhe akomodimit hotelier në ishujt Hvar dhe Braç në Republikën e Kroacisë), dhe në një masë më të vogël, si veprimtari dytësore, me aktivitete bujqësore (plantacione vetjake me hardhi dhe ullinj) për prodhimin e sasisë së vogël të verës dhe vajit të ullirit, të destinuar për shitje brenda Grupit ORBICO.

ORVAS shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për tregti është pjesë e Grupit ORBICO dhe është 100% në pronësi të ORBICO SHPK për tregti Zagreb. ORBICO SHPK me seli në rr. Koturaška Cesta 69, Zagreb, Republika e Kroacisë, është shoqëri që merret kryesisht me tregti me shumicë dhe njëkohësisht është përfaqësues dhe distributor në territorin e Kroacisë për shumë marka që variojnë nga produkte për kujdes dhe bukuri, produkte ushqimore dhe jo-ushqimore, pajisje teknike dhe elektrike, barna, lodra, tekstil, cigare, vajra motorike dhe shumë produkte të tjera.

Grupi ORBICO është i pranishëm edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes:

Shoqërisë për tregti dhe shërbime ORBICO SHPK Shkup, me seli në rr. Boris Trajkovski nr. 286, Komuna Kisella Vodë, 1000 Shkup, me veprimtari kryesore – tregti jo e specializuar me shumicë. Shoqëria është përfaqësues dhe distributor në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për shumë marka të produkteve ushqimore, vajrave motorike, baterive, parfumeve, ujërave të tualetit dhe deodorantëve, kozmetikës dekorative, produkteve për higjienë personale, për kujdes dhe për mirëmbajtjen e higjienës në amvisëri.

TURE shoqëri për hotelieri, turizëm, ndërtimtari dhe tregti SHPK është shoqëri që merret veçanërisht me veprimtari turistike në territorin e Republikës së Kroacisë (është pronare e Hotelit LIPA në Postira, në ishullin Braç, Kroaci – që është edhe qëllimi kryesor i kësaj transaksioni) dhe të gjithë veprimtarinë afariste e ushtron ekskluzivisht në territorin e Republikës së Kroacisë.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtje të konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni u bën thirrje palëve të treta të interesuara të dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre lidhur me këtë përqendrim deri te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr.54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk, dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

11.06.2025

Shkup